



P Z A P  
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.473/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj e Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Koalicionit, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-NISMA, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 11.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.473/2025, e datës 09.02.2025, paraqitur kundër koalicionit, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-NISMA me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 09.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identikuara me numër Anr.473/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, me te cilën pretendon se më 8 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë ka identifikuar se kandidati për deputet i AAK-së z. Bekë Berisha ka shpërndarë në instagramin personal e tij një intervistë të bërë në Klan Kosova i cili "*akuzon qeverinë për arrogancë, përqarje, lënje të ushtrisë pa buk, pa uniforma, i ka detyru policinë me protestu, gjithashtu akuzon qeverinë dështim, kaos, dhe shpërfillje të dy shtyllave kryesore të sigurisë( ushtrisë dhe policisë)*". Me këto deklarata sipas parashtruesit te ankesës Bekë Berisha si kandidat nga radhët e subjektit politik AAK ka bërë Shkelje të 34 par. 1 nëparagrafi 1.11 të LZP-së. Si Provë ka bashkangjitur: CD dhe <https://www.instagram.com/reel/DFyCwfQsxgh/?igsh=MW93MXZjYnFtb2Fleg>.

Në përgjigjen në ankesa të koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK-NISMA, se kinse z. Bekë Bërisha ka përdorur gjuhë të papërshtatshme duke e akuzuar qeverinë për arrogance e përçarje, në asnjë moment nuk përbush elementet materiale për tu shkelur dispozita 1.11 të nenit 34 të LZP-së, dhe i njëjtë ka shprehur opinion, në një vend demokratik kritika dhe opozitarizmi si dhe kërkimi i llogarisë politike është vlerë e shto këtu faktin se vetë Kushtetuta e Kosovës e garanton lirinë e shprehjes, e çka të bëjë me mundësinë që individët të shprehin mendimet, idetë, besimet dhe ndjenjat e tyre pa pasur frikë nga ndëshkimi, censura, ose represioni. Kjo është një e drejtë themelore që garanton mundësinë e komunikimit të lirë dhe të hapur në shoqëri, duke mbrojtur shprehjen e mendimeve të ndryshme dhe të kundërtë. Liria e shprehjes është një nga shtyllat kryesore të një shoqërie demokratike, e cila mundëson shkëmbimin e ideve dhe rritjen e mendimit kritik dhe zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi. Të njëjtit konsiderojnë se ankesa është e pabazuar dhe e mangët në përbajtje.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

**-Ankesa është e pabazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik AAK, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj përfaktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: "*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalojen nga bërja e ndonjërit si në vijim: përdorimi i gjuhës, nëformën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër përfakti kryer një akt të dhunës kundër personave tjera ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografji, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*".

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik LVV, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, përfaktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që në fjalimin e kandidatit përfaktor i koalicionit AAK-Nisma, z. Berisha në të cilën theksohet se në llogarinë personale të rrjetit social Instagram ka shpërndarë shkrimin ku "akuzon qeverinë për arrogance, përçarje, lënje të ushtrisë pa bukë, pa uniforma, i ka detyru policinë me protestu, gjithashtu akuzon qeverinë dëshitim, kaos, dhe shpërfillje të dy shtyllave kryesore të sigurisë (ushtrisë dhe policisë)", sipas vlerësimit të Panelit është në përputhje me diskursin e fushatës zgjedhore dhe i njëjti nuk ka fyter, degraduar apo nxitje të urrejtjes ndaj subjektit politik Vetëvendosje apo të Qeverisë së Kosovës dhe nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar përfaktor i referohet pala ankuase. Andaj duke u mbështetur në nenin 17.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja përfaktor i ankesës* nga

*PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, përfaktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lart.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.473/2025 datë 11.02.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.